



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
NJËSIA E INSPEKTORËVE**

Nr. 1019/ prot.
12

Datë 14 . 10 . 2025

RAPORT

“PËR

**KRYERJEN E INSPEKTIMIT TEMATIK ME OBJEKT “MBI PROCEDURËN
E SHPALLJES DHE ARSYETIMIT TË VENDIMEVE GJYQËSORE TË
GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË
PËRGJITHSHËM GJIROKASTËR, PËR PERIUDHËN 01.04.2024-30.06.2024”**

Në zbatim të vendimit nr. 16, datë 01.04.2025 “Mbi procedurën e shpalljes dhe
arsyetimit të vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të
Përgjithshëm Gjirokastër, për periudhën 01.04.2024-30.06.2024”,
të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

Tiranë më, 14 . 11 . 2025

INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME MBI RAPORTIN

Titulli:

Raporti i inspektimit tematik me objekt "Mbi procedurën e shpalljes dhe arsyetimit të vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, për periudhën 01.04.2024-30.06.2024",
të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

Data e përgatitjes:

14.11.2025

Përgatitur nga:

znj. Erjena Bashari
znj. Joana Sorraj



Për shqyrtim nga:

Inspektori i Lartë i Drejtësisë

z. Artur Metani

Mirato ☒ Ndryshoi ☐ Ktheu ☐

Datë 14.11.2025



I. Pjesa hyrëse

Në mbështetje të nenit 194, pika 4 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë (këtu e në vijim ILD) kryen inspektime institucionale e tematike mbi çdo aspekt të punës së gjykatave, administratës gjyqësore, zyrave të prokurorive dhe administratës së prokurorisë.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë në përmbushje të detyrave të tij të përcaktuara në nenin 147/d të Kushtetutës, në zbatim të nenit 194, pika 4 dhe nenit 204, pika 1, shkronjat "dh", "ë" dhe "k" të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, ka miratuar me vendimin nr. 5, datë 31.01.2025 "*Planin e inspektimeve për vitin 2025*".

Në këtë kuadër, nisur nga ushtrimi i kompetencave të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë përsa i përket kontrollit të veprimtarisë së magistratëve dhe bazuar në vendimin nr. 5, datë 31.01.2025 "*Planin e inspektimeve për vitin 2025*" është planifikuar zhvillimi i një Inspektimi Tematik me objekt: "Mbi procedurën e shpalljes dhe arsyetimit të vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, për periudhën 01.04.2024-30.06.2024" të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Për kryerjen e inspektimit sipas vendimit nr. 16, datë 01.04.2025 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, u angazhuan inspektorët, znj. Erjena Bashari dhe znj. Joana Sorraj. Gjithashtu, me qëllim rritjen e eficiencës së grupit të inspektimit dhe miradministrit të procesit, me të njëjtin vendim është caktuar si kryetar grupi inspektori znj. Erjena Bashari.

Për realizimin e këtij inspektimi, me vendimin nr. 49, datë 15.09.2024 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është kryer shtyrja e afatit për përfundimin e tij, duke konsideruar sasinë e informacionit të mbledhur, kohën e nevojshme për të përpunuar dhe vlerësuar informacionin si edhe nevojën për të trajtuar të gjithë informacionin e nevojshëm në kuadër të inspektimit tematik.

Arsyeja e inicimit të këtij inspektimi konsiston në ankesat e paraqitura pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në të cilat ngriheshin pretendime për vonesa në zbardhjen e vendimeve gjyqësore përtej afateve ligjore ndaj magistratëve gjyqtarë të Gjykatës së Shkallës së Parë Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër si dhe për të krijuar një pasqyrë reale të gjendjes faktike të dorëzimit të vendimeve gjyqësore të përfunduara nga ana e magistratëve.

Burimet e së drejtës, në të cilën është mbështetur puna e inspektorëve, gjatë vlerësimit të kryerjes së veprimtarisë së gjyqtarëve lidhur me objektin e inspektimit janë:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë;
- Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë;



- Ligji “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”;
- Raporti i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e KLGJ-së për vitin 2024;
- Analiza vjetore e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjyrokastër për vitin 2024;
- Rregullore e brendshme për organizimin dhe funksionimin e veprimtarisë gjyqësore dhe administrative të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjyrokastër nr. 109 prot., datë 04.07.2014.

Kryerja e inspektimit është planifikuar sipas vendimit të inspektimit, për realizimin e tij në 4 faza:

- 1) Faza e parë: “Përgatitja e planit të punës, hartimi i kërkesave për informacion dhe akte, si dhe zhvillimin e verifikimeve apo vizitave pranë gjykatës”. Kjo fazë ka përfshirë hapat si më poshtë:
 - a) Është hartuar plani i punës, i dakordësuar nga inspektorët në datën 03.04.2025;
 - b) Janë hartuar shkresat drejtuar gjykatave objekt inspektimi, sipas një modeli të dakordësuar nga inspektorët, të cilat janë nisur në datën 04.04.2025;
 - c) Është administruar informacioni dhe dokumentacioni, si dhe është realizuar përpunimi i tyre paraprak.
- 2) Faza e dytë: “Përpunimi i të dhënave dhe informacionit të mbledhur”. Kjo fazë ka përfshirë hapat si më poshtë:
 - a) Përpunimi i të dhënave dhe informacionit të mbledhur dhe studimi i tyre;
 - b) Vlerësimin nëse duhet të merren të dhëna të tjera, informacioni dhe dokumentacion plotësues, të vlerësuar nga grupi i inspektorëve, nëpërmjet dërgimit të shkresës, komunikimit me anë të telefonit dhe vizitës në terren.
- 3) Faza e tretë: “Hartimi i Raportit të Inspektimit”, që ka përfshirë këto hapa:
 - a) Hartimi i raporteve të veçanta për secilën nga gjykatat që janë përfshirë në inspektim sipas një model/strukture të njëjtë;
 - b) Hartimi i projekt raportit përfundimtar, i cili do të dërgohet për shqyrtim pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Pas shqyrtimit dhe daljes së Raportit nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, do të kalohet në fazën e fundit:

- 4) Faza e katërt: “Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve dhe rezultateve të inspektimit”.
 - Gjatë periudhës së zhvillimit të inspektimit janë konstatuar në mënyrë të përmbledhur problematika të lidhura me:
 - Mospërputhje midis materialit shkresor dhe tabelave të plotësuar, nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjyrokastër për

këtë inspektim. Disa çështje të cilat rezultojnë në regjistra nuk rezultojnë në tabelat e plotësuara nga gjykata dhe anasjelltas.

- Regjistrat e çështjeve “Pushim procedimi”, janë plotësisht të palexueshëm duke e bërë të pamundur konkludimin për këtë pjesë të çështjeve të trajtuara dhe të shpallura nga kjo gjykatë për periudhën objekt inspektimi.
- Librat e regjistrimit të vendimeve kanë pasur pasaktësi në mënyrën e numërimit, si numërtime të gabuara dhe/ose numra të kapërcyer. Për çështje konkrete për shkak të mënyrës jo të qartë të regjistrimit të të dhënave në regjistrat përkatës bëhet i vështirë identifikimi i palëve pjesëmarrëse në proces dhe numrit të vendimit përkatës.
- Inspektimi Tematik përfshiu veprimtarinë e gjykatës subjekt të këtij inspektimi, për periudhën 01.04.2024 - 30.06.2024.
- Fokusi i inspektimit tematik u përqendrua kryesisht në tre drejtime kryesore:
 - (i) Datën e shpalljes së vendimit gjyqësor;
 - (ii) Datën e depozitimit të vendimit të arsyetuar në sekretari;
 - (iii) Datën e njoftimit të vendimit të arsyetuar palëve.

Qëllimi i këtij inspektimi është vlerësimi i praktikave të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, lidhur me zbatimin e kushteve ligjore mbi shpalljen dhe depozitimin e vendimeve gjyqësore të arsyetuara në sekretari duke informuar me vërtetësi mbi gjendjen e organit të inspektuar.

Në këtë inspektim është vlerësuar veprimtaria e gjyqtarëve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, në respektimin e afateve ligjore të përcaktuara për shpalljen dhe dorëzimin e vendimeve të arsyetuara në sekretari.

Nisur nga problematikat e konstatuara gjatë objektit të punës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Inspektimi Tematik paraqet rëndësi në krijimin e një panorame të përgjithshme mbi zbatimin e afateve ligjore në zbardhjen e vendimeve gjyqësore dhe dorëzimit të dosjeve në kryesekretarinë e gjykatave, për të vijuar me komunikimet e vendimeve palëve, për të siguruar njoftimin në kohë dhe fillimin e afatit të ankimit, pa sjellë vonesa për palët ndërgjyqëse dhe në zbatimin e përcaktimeve ligjore për këtë qëllim.

Inspektimi i zhvilluar mbi veprimtarinë e Gjykatës së Shkallës së Parë Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër mundësoi njohjen dhe krijimin e një tabloje të përgjithshme mbi respektimin e afateve ligjore për arsyetimin e vendimeve gjyqësore të shpallura, si dhe depozitimin e tyre së bashku me dosjet në sekretari nga magjistratët gjyqtarë.

- Nga të dhënat e administruara gjatë inspektimit për periudhën 01.04.2024 deri më 30.06.2024 rezultoi se në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë janë shpallur:

- **181 vendime civile të themelit** të cilat janë dorëzuar të gjitha në kryesekretarinë e kësaj gjykate. Nga këto 94 vendime ose 51.7 % e totalit të vendimeve të shpallura janë arsyetuar dhe depozituar në sekretari brenda afatit ligjor 20 ditor, 35 vendime ose 19.2 % e totalit të vendimeve të shpallura janë dorëzuar të arsyetuara në sekretari brenda afatit 21-30 ditor, 21 vendime ose 11.5 % e totalit të vendimeve të shpallura janë dorëzuar të arsyetuara në sekretari brenda afatit 31-60 ditor, 23 vendime ose 12,6 % e totalit të vendimeve të shpallura janë dorëzuar të arsyetuara në sekretari brenda afatit 61-90 ditor, 9 vendime ose 5 % e totalit të vendimeve të shpallura janë dorëzuar të arsyetuara në sekretari brenda afatit 91-120 ditor, 0 vendime ose 0 % e totalit të vendimeve të shpallura janë dorëzuar të arsyetuara në sekretari mbi afatin 121 ditor, i padorëzuar deri në datën 30.05.2024 nuk rezulton asnjë vendim.

- **53 vendime kërkesa civile** të cilat janë dorëzuar të gjitha në kryesekretarinë e kësaj gjykate. Nga këto 45 vendime ose 85 % e totalit të vendimeve të shpallura janë arsyetuar dhe depozituar në sekretari brenda afatit ligjor 20 ditor, 8 vendime ose 15 % e totalit të vendimeve të shpallura janë arsyetuar dhe depozituar në sekretari brenda afatit 21-30 ditor.

- **78 vendime penale themeli**, të cilat për shkak të afateve të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale, janë kategorizuar sipas afateve të dorëzimit të tyre pas shpalljes së vendimit në penale themeli ku personi i dënuar është me masë sigurimi personal të cilat në total për periudhën e inspektuar janë **23 çështje** dhe në penale themeli me të dënuar pa masë sigurimi personal të cilat në total janë **55 çështje**. Për shkak të afateve ligjore të ndryshme që përdoren për secilën prej kategorive, në pjesën e analizës ligjore të këtij inspektimi gjendet kategorizimi i çështjeve në raport me afatet ligjore të parashikuara nga KPP.

- **68 vendime të seancave paraprake**. Për shkak të parashikimit të përcaktuar në nenin 332/dh të Kodit të Procedurës Penale përse i përket këtyre çështjeve, në varësi të “germës” të nenit të cilit i përgjigjen natyra e vendimmarrjes së gjykatës si dhe parashikimi ligjor përkatës, trajtohen me afate të ndryshme dorëzimi pas dhënies së vendimit. Në këtë optikë ndarja për secilën kategori është e pasqyruar në pjesën e analizës ligjore të këtij raporti. Në totalin e vendimeve të seancave paraprake për periudhën e inspektuar rezultuan që **53 çështje** janë trajtuar sipas germës “c” të cilat i referohen afateve të dorëzimit të parashikuar në nenit 382 të Kodit të Procedurës Penale dhe **15 çështje** të cilat janë trajtuar sipas germës “a” të nenit 332/dh dhe për të cilat afati i parashikuar për dorëzimin e vendimit pas shpalljes së tij është 10 ditor, nga këto 10 ose 73,3 % e totalit janë brenda afatit ligjor 10 ditor, 3 ose 20 % e totalit janë brenda afatit 11-20 ditor dhe 1 ose 6,7 % e totalit janë brenda afatit 21-50 ditor.

- **264 vendime pushim procedimi**, të cilat janë trajtuar nga kjo gjykatë për periudhën e inspektuar dhe të cilat përse i përket afatit të dorëzimit të tyre pas shpalljes së vendimit

trajtohen sipas nenit 382 të Kodit të Procedurës Penale. Nga dokumentacioni i administruar gjatë inspektimit rezulton se 218 ose 82.5 % e totalit të vendimeve të pushimit janë arsyetuar brenda afatit 30 ditor, 29 ose 11 % e totalit të vendimeve brenda afatit 31-40 ditor, 7 ose 2.7 % e totalit të vendimeve brenda afatit 41-60 ditor, 1 ose 0.4 % e totalit brenda afatit 61-90 ditë, 9 ose 3.4 % e totalit të vendimeve mbi 90 ditë.

- **160 vendime kërkesa penale**, në të cilat përfshihen të gjitha kërkesat që lidhen me masat e sigurimit personat që janë **65** për periudhën e inspektuar, kërkesat për lejim përgjimi dhe zgjatje afati për lejim përgjimi të cilat janë **42**, kërkesat për shuarjen e masave të sigurimit të cilat për periudhën e inspektuar janë **12** dhe të gjitha kërkesat e tjera penale të cilat ngrihen pranë gjykatës pas dhënies së vendimit të themelit të cilat janë **41** për periudhën e inspektuar.

Numri i gjyqtarëve sipas strukturës organizative gjatë vitit 2024 është 7, ndërsa numri i gjyqtarëve që ushtrojnë efektivisht detyrën pranë kësaj gjykate është 4. Ngarkesa mesatare vjetore e një gjyqtari të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjyrokastër është 1010 çështje për gjyqtar, një rritje kjo, e krahasuar me vitin 2023 (887.4 çështje).

Pavarësisht afateve të parashikuara në ligjin procedural civil dhe penal, rezulton se këto afate jo gjithmonë mund të zbatohen me rigorozitet nga ana e gjyqtarëve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, për shkak të ngarkesës së shtuar dhe numrit të kufizuar të gjyqtarëve që ushtrojnë efektivisht detyrën për periudhën e inspektuar. Pra, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjyrokastër, rezulton se: 71.2 % e vendimeve civile të themelit si dhe 100 % e kërkesave civile, janë dorëzuar brenda afatit 30 ditor, si koha e arsyeshme që i nevojitet gjyqtarit/gjykatës të dorëzojë vendimin përfundimtar të arsyetuar, për këtë periudhë të inspektuar, në kushtet që është ndodhur gjykata në këtë interval kohor. Rezulton gjithashtu që pjesa i përket çështjeve penale në tërësi, pavarësisht afateve të tyre specifike, rreth 74.4 % janë dorëzuar brenda afateve ligjore dhe pjesa tjetër janë dorëzuar jashtë këtyre afateve secila kategori sipas përcaktimeve përkatëse.

Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjyrokastër pjesa i përket librave të dorëzimit të dosjeve në kryesekretari, evidentohet fakti që secili gjyqtar ka një libër personal të sekretuar dhe numërtuar, i cili administrohet nga sekretarja gjyqësore e seancës, e cila firmos në ditën e dorëzimit të dosjes në kryesekretari dhe kundërfirmohet nga kryesekretaria.

II. Objekti i kontrollit dhe analiza ligjore

Inspektimi Tematik filloi me fazën e parë, hartimin e kërkesës për informacion dhe akteve drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjyrokastër nr. 1019/3 prot., datë 03.04.2025.

Nga ana e inspektorëve, në funksion të realizimit të inspektimit, janë administruar të dhëna nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjyrokastër, ku është

mundësuar marrja e informacionit dhe dokumentacionit përkatës, nëpërmjet shkresave të dërguara nga kjo zyrë me nr. 210 prot., datë 30.05.2025^[1], nr. 210/2 prot., datë 11.06.2025^[2]. Gjatë inspektimit është kryer verifikimi i të dhënave pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër^[3].

Të dhënat e marra nga gjykata sa më sipër lidhen me informacionin dhe dokumentacionin shkresor të mëposhtëm gjatë periudhës kohore objekt të inspektimit 01.04.2024-30.06.2024:

- i. Fotokopje e librave të dorëzimit të sekretareve gjyqësore;
- ii. Numëror civil/penal;
- iii. Regjistër/numëror i masave të sigurimit;
- iv. Regjistër/numëror i urdhrave të mbrojtjes;
- v. Regjistër/numëror i urdhrave të ekzekutimit;
- vi. Regjistër/numëror i çështjeve penale paraprake;
- vii. Regjistër/numëror i çështjeve penale dhe civile të veçanta.

Gjithashtu nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër janë dërguar të plotësuara tabelat e dorëzimit të çështjeve penale dhe tabelat e dorëzimit të çështjeve civile, të cilat janë vendosur në dispozicion të ILD-së nëpërmjet CD-së bashkëlidhur shkresës së gjykatës, por edhe në e-mailin zyrtar në formë elektronike.

Referuar qëllimit dhe objektivit të inspektimit, analiza e të dhënave të marra nga zyrat e gjykatës, është përqendruar në drejtim të (i) datës së shpalljes së vendimit gjyqësor, (ii) datës në të cilën dosja e plotë gjyqësore së bashku me vendimin përfundimtar të arsyetuar është dorëzuar në kryesekretari, (iii) datën e komunikimit të vendimit gjyqësor palëve ndërgjyqëse.

- Trajtimi i këtyre të dhënave, është bazuar në analizën dhe interpretimin e dispozitave përkatëse të: Kushtetutës, Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë; Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë; ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Raportit të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e KLGJ për vitin 2024; Analizës vjetore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër për vitin 2024; Vendimit të KLGJ nr. 150, datë 29.03.2023 “Për Miratimin e “Rregullave standarde për organigramën dhe përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Kategoria e dytë dhe e tretë me Zyra Shërbimi””; Rregullore e veprimtarisë administrative të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër nr. 109 prot., datë 04.07.2014.

¹ Regjistruar në ILD me nr. 1019/4 prot., datë 16.06.2025.

² Regjistruar në ILD me nr. 1019/5 prot., datë 16.06.2025.

³ Shih procesverbalin nr. 265/1 prot., datë 11.07.2025.

Me qëllimin që analizimi i të dhënave të mbledhura të ishte sa më gjithëpërfshirës, objektiv dhe shterues, nga grupi i inspektimit u morën edhe të dhëna të përgjithshme të sistemit të drejtësisë në vend, konkretisht raportet vjetore të Këshillit të Lartë Gjyqësor për gjendjen e sistemit gjyqësor në vitin 2024 periudhë objekt inspektimi.

Sipas KLGJ gjatë vitit 2024, kanë ushtruar efektivisht funksionin e gjyqtarit në gjykatat e të gjitha niveleve, gjithsej 272 gjyqtarë në të njëjtën periudhë kohore. Kjo nënkupton se sistemi gjyqësor gjatë vitit 2024 ka funksionuar me pothuajse 66.6 % të kapacitetit të tij, pothuajse me 6.6 % më shumë se në vitin 2023, e cila ka rezultuar me 247 gjyqtarë që kanë ushtruar efektivisht detyrën. Kontribuues kryesor në rritjen e numrit të gjyqtarëve efektivisht në detyrë kanë qenë kryesisht emërimet e magistratëve të rinj. Nga të dhënat që disponon Drejtoria e Burimeve Njerëzore rezulton se numri i vakancave në sistem, për gjyqtarë është 136 vakanca (nga të cilat 75 të përhershme^[4] dhe 61 vakanca të përkohshme^[5]). Nëse marrim në shqyrtim një ndër treguesit e menaxhimit të burimeve njerëzore që përdoret edhe nga CEPEJ, numrin e gjyqtarëve në raport me popullsinë, sikurse vihet re sipas tabelës së mëposhtme, Shqipëria është ende larg mesatares evropiane.

Nr.	Raporti numër gjyqtarësh /100 mijë banorë, sipas strukturës organizative	Raporti numër gjyqtarësh/100 mijë banorë, sipas organikës në fakt	Raporti numër gjyqtarësh/100 mijë banorë, sipas organikës efektive në fakt	Mesatarja evropiane, sipas CEPEJ-it
1	14.80 gjyqtarë/100 mijë	12.05 gjyqtarë/100 mijë	9.85 gjyqtarë/100 mijë	21.9 gjyqtarë/100 mijë

Nga raporti i KLGJ-së referuar gjendjes së sistemit gjyqësor gjatë vitit 2024 ndër të tjera rezulton se:

- Gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm kanë nisur vitin 2024 me një stok prej 43,853 çështjesh të mbartura, që përfaqëson një rritje prej 9.4 % krahasuar me vitin 2023. Nga ky stok 32,213 çështje janë civile (73.5 %) dhe 11,640 çështje janë penale (26.5 %).
- Struktura e backlog-ut, paraqitet në 71 % çështje civile dhe 29 % çështje penale.
- Në vitin 2024 janë regjistruar 84,720 çështje të reja, nga të cilat 45 % janë civile (38,448 çështje) dhe 55 % janë penale (46,272 çështje).
- Në vitin 2024, rendimenti mesatar për gjyqtar (ER) është 516 çështje për gjyqtar, një ulje prej 5.7 % krahasuar me vitin paraardhës.

⁴ Vakancë e përhershme është diferenca e strukturës organizative me organikën në fakt.

⁵ Vakancë e përkohshme është diferenca e organikës në fakt me efektivitetin në detyrë.

- Në vitin 2024, gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm kanë bërë përparime të dukshme në eficiencën dhe kohëzgjatjen e trajtimit të çështjeve, veçanërisht në gjykimet penale.
- Reduktimi i ngarkesës mesatare për gjyqtar, përmirësimi i treguesit CR dhe ulja e kohës së zgjidhjes së çështjeve tregojnë një rritje të kapacitetit operacional dhe efektet pozitive të zbatimit të Hartës së Re Gjyqësore dhe Strategjisë për Uljen e Backlog-ut 2024-2027.
- Pavarësisht këtyre përmirësimeve, backlog-u civil mbetet ende një sfidë, duke kërkuar më shumë ndërhyrje për rritjen e rendimentit, që të arrihet një reduktim i qëndrueshëm i stokut dhe të garantohet një drejtësi e aksesueshme dhe e shpejtë për të gjithë qytetarët.
- Gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm të shkallëve të para e mbyllin vitin 2024 me 42,070 çështje të pazgjidhura të cilat përbëjnë një barrë e cila kërkon rritje të numrit të gjyqtarëve si edhe stafit mbështetës në funksion të miradministrimit të drejtësisë.

Në vijim është pasqyruar analiza ligjore me të dhënat përkatëse që janë përpunuar mbi subjektin e inspektimit, pas trajtimit të informacioneve të dërguara nga gjykatat, raportet vjetore të punës të secilës gjykatë, informacionit të trajtuar në raportet vjetore të KLGJ-së për këto gjykata. Pjesë e analizës ligjore për secilën gjykatë është situata aktuale që rezulton nga gjetjet e inspektimit si, ngarkesa e gjykatës duke përfshirë çështjet e mbartura nga viti i mëparshëm, ato të regjistruara rishtazi, si dhe gjendja reale e burimeve njerëzore të gjykatave.

➤ **Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër**

Në përgjigje të kërkesës së ILD-së për të dhëna në kuadër të inspektimit tematik, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër^[6] për periudhën kohore objekt të inspektimit 01.04.2024-30.06.2024 vendosi në dispozicion:

- Fotokopje e librave të dorëzimit të sekretareve gjyqësore;
- Numëror civil/penal;
- Regjistër/numëror i masave të sigurimit;
- Regjistër/numëror i urdhrave të mbrojtjes;
- Regjistër/numëror i urdhrave të ekzekutimit;
- Regjistër/numëror i çështjeve penale paraprake;
- Regjistër/numëror i çështjeve penale dhe civile të veçanta.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër me shkresën nr. 210 prot., datë 30.05.2025 regjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 1019/4, datë 09.06.2025 përcjell tabelën e plotësuar për dosjet civile dhe për dosjet penale.

⁶ Me shkresën nr. 210/2 prot., datë 11.06.2025 regjistruar pranë ILD-së me nr. 1019/5 prot., datë 16.06.2025.

Nga dokumentacioni i administruar gjatë inspektimit rezulton se pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër gjenden librat e dorëzimit të dosjeve në sekretari për vitin 2024 të veçantë për çdo gjyqtar.

Nga shqyrtimi i librit të dorëzimeve të dosjeve gjyqësore konstatohet se në to pasqyrohen të dhëna lidhur me numrin e aktit, datën e regjistrimit, paditësin, numrin e vendimit, datën e vendimit, objekti, datë e dorëzimit të vendimit gjyqësor të arsyetuar, datën e dorëzimit në sekretari dhe nënshkrimet përkatëse të sekretarit të seancës gjyqësore dhe kryesekretarit.

Nga shqyrtimi i regjistrit të çështjeve të veçanta civile konstatohet se në to pasqyrohen të dhëna në lidhje me numrin, datën e paraqitjes së kërkesës, kërkuarit, palët në proces, objekti, dispozitivi, gjyqtari, data e dhënies së vendimit, vërejtje.

Nga shqyrtimi i regjistrit për sigurim padie, urdhër ekzekutimi konstatohet se në to pasqyrohen të dhëna në lidhje me numrin, datën e paraqitjes së kërkesës, kërkuarit, palët në proces, objektin, dispozitivin, gjyqtarin, datën e dhënies së vendimit, vërejtje.

Nga shqyrtimi i regjistrit të kërkesave penale konstatohet se në to pasqyrohen të dhëna në lidhje me numrin, datën e paraqitjes së kërkesës, kërkuarit, palët në proces, objektin, dispozitivin, gjyqtarin, datën e dhënies së vendimit, vërejtje.

Nga shqyrtimi i regjistrit të veçantë për masat ndaj dhunës në familje konstatohet se në to pasqyrohen të dhëna në lidhje me numrin, datën e regjistrimit, paditësin, të paditurin, objektin, datën e vendimit, dispozitivin (recidivit/mosha/profesionin), shkollimi, gjyqtari i çështjes.

Nga analiza e numërorit të vendimeve penale themeli konstatohet se në të pasqyrohen të dhëna në lidhje me numrin dhe datën e shpalljes së vendimit, numrin dhe datën e regjistrimit, të pandehurin, akuzën dhe nenin, mënyrën e përfundimit, gjyqtarin, anëtarët, numrin e seancave, afatin, Apeli, Gjykata e Lartë.

Nga analiza e numërorit civil konstatohet se në të pasqyrohen të dhëna në lidhje me numrin dhe datën e shpalljes së vendimit, numrin dhe datën e paraqitjes, numrin dhe datën e regjistrimit, palët (paditës, i paditur, palë e interesuar), objekti, dispozitivi, trupi gjykues, anëtarët, numri i seancave, afati i dorëzimit, Apeli, Gjykata e Lartë.

Nga analiza vjetore e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër⁷ rezulton se fillimi i vitit 2024 e gjeti gjykatën me 4 gjyqtarë si më poshtë: Suela Dashi (e cila me vendimin nr. 170, datë 03.04.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor është transferuar me transferim të përkohshëm në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës), Marjola Beluli (e cila me vendimin nr. 476, datë 31.07.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor është transferuar me transferim të përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës), Entela Selmanaj (e cila prej datës 08.10.2024 ushtron funksionin e Zëvendëskryetares pranë

⁷ Marrë nga faqja zyrtare e gjykatës.

kësaj gjykate), Nertila Përallaj. Pas transferimit të dy gjyqtareve në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, trupa gjyqësore e kësaj gjykate, në një pjesë të madhe të vitit kalendarik 2024, ka qenë e përbërë vetëm prej dy gjyqtareve Entela Selmanaj dhe Nertila Përallaj dhe ngarkesa e punës ka qenë tepër e lartë. Në muajin tetor e në vijim, përbërja e trupës gjyqësore në këtë gjykatë, pas emërimit të dy magistratëve të reja, ka qenë si më poshtë: Entela Selmanaj (Zëvendëskryetare), Nertila Përallaj, Ermira Bushi (emëruar me vendimin nr. 576, datë 02.10.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor), Orinda Lloshi (emëruar me vendimin nr. 581, datë 02.10.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor) Për shkak të numrit të vogël të gjyqtarëve, gjykata nuk është e ndarë në dhoma civile/penale. Gjyqtarët kanë gjykuar çështje penale, civile, kërkesat paraprake si dhe çështjet penale me të mitur në konflikt me ligjin ose të mitur viktimë nga vepra penale, në mbështetje të nenit 282 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, të miratuar edhe me ligjin nr. 37/2017 dhe Udhëzimit nr. 79, datë 30.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Nga raporti i Këshillit të Lartë Gjyqësor mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e KLGJ për vitin 2024^[8] konstatohet se numri i gjyqtarëve sipas strukturës organizative së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër është 7, ndërsa magistratë efektivisht në detyrë janë 4 magistratë^[9]. Ngarkesa mesatare vjetore e një gjyqtari të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër është 1010 çështje, ndërsa ngarkesa mesatare për gjyqtarë ka qenë **750** çështje.

Marrë në konsideratë sa më sipër, në kuadër të një analize të gjithanshme mbi situatën faktike të gjendjes së gjykatave është i domosdoshëm krijimi i një panorame të plotë referuar ligjit procedural civil dhe penal, si dhe praktikës gjyqësore në raport me objektin e inspektimit me tematikë “Mbi procedurën e shpalljes dhe arsyetimit të vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër për periudhën 01.04.2024-30.06.2024”.

Referuar kuadrit ligjor në fuqi janë përcaktuar qartë detyrimet e magistratëve në realizimin e detyrave të tyre funksionale, në nenin 3, pika 5 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është parashikuar se sjellja e magistratit është e lidhur me garantimin e ruajtjes dhe forcimit të besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë. Nëse magistratët nuk e përmbushin plotësisht rolin e tyre për dhënien dhe sigurimin e drejtësisë në shoqëri, ekziston rreziku i humbjes së besimit të publikut në sistemin e drejtësisë. Besimi i publikut dhe respekti për gjyqësorin janë garanci të demokracisë dhe stabilitetit në një shoqëri demokratike. Në referim të jurisprudencës së Gjykatës së Lartë^[10] dhe asaj Kushtetuese^[11], gjykatat

⁸ Marrë nga faqja zyrtare e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

⁹ Pasqyra e numrit të magistratëve (gjyqtarë) në gjykatat e të gjitha niveleve, për vitin 2024, fq. 33 e Raportit të KLGJ “Mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2024”.

¹⁰ Vendimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 5, datë 12.12.2013.

¹¹ Vendimi nr. 8, datë 16.03.2011; Vendimi nr. 23, datë 04.11.2008; Vendimi nr. 11, datë 02.04.2008.

kanë detyrimin që të respektojnë parimin e rëndësishëm “të përfundimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm”.

Gjykata Kushtetuese ka theksuar domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimeve gjyqësore, penale apo civile, si një garanci për procesin ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Vendimi mund të kontrollohet nga një gjykatë më e lartë sipas procedurave përkatëse dhe që kjo të jetë e mundur, duhet bërë arsyetimi i vendimit, në të cilin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm, të cilat e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit, përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se edhe duke marrë në konsideratë shkaqet objektive (*ngarkesa e punës, kompleksiteti i çështjeve, shkaqe të arsyeshme personale, shëndetësore, familjare*), vendimet gjyqësore duhet të dorëzohen brenda një afati të arsyeshëm. Në çdo rast duhet të gjenden zgjidhje ligjore brenda institucionit në mënyrë që dorëzimi i tyre të mos marrë më shumë kohë se sa ka marrë vetë procesi gjyqësor, apo ato të mbahen pafundësisht të bllokuara dhe të padorëzuara, sepse vonesa të tilla ndikojnë dhe kanë efekt të drejtpërdrejtë tek palët në proces, pasi u cenohen këtyre të fundit të drejtat e tyre kushtetuese dhe përfundimisht procesi gjyqësor rezulton në një proces joefektiv.

Një vendim i vonuar madje mund të zhbëjë edhe vetë arsyen për të cilën është dhënë vendimi, pasi dhënia e tij në vonesë, mund të bëjë që ai të jetë krejt i pavlefshëm për palën e interesuar. Parimi i gjykimit brenda afatit të arsyeshëm përbën një nga elementët e procesit të rregullt ligjor të parashikuar në nenin 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, (KEDNJ) dhe në referim të praktikës së GJEDNJ-së është përcaktuar se periudha e afatit të arsyeshëm për përfundimin e një procesi gjyqësor civil, shtrihet që nga momenti i ngritjes së padisë deri tek momenti i ekzekutimit të vendimit gjyqësor^[12].

Arsyetimi i vendimit përbën një nga elementët e procesit të rregullt gjyqësor, pasi përmes tij palët dhe pjesëmarrësit e tjerë në proces mund të njihen me argumentet mbi të cilat gjykata e ka mbështetur vendimmarrjen e saj dhe kanë mundësinë më tej për të parashtruar kundërshtimet e tyre në gjykatat e një niveli më të lartë. Nga ana tjetër, arsyetimi i vendimit është një mjet me të cilin publiku i gjerë njihet me mënyrën e administrimit të drejtësisë nga gjykatat, duke ushtruar kontrollin e tij mbi respektimin e parimit të shtetit të së drejtës.

Në Kodin e Procedurës Civile është parashikuar afati njëzetditor i arsyetimit të vendimit gjyqësor (neni 308 paragrafi i dytë). Ky afat synon disiplinimin në mënyrë të arsyeshme

¹². <https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-65116>.

të punës së gjykatës në lidhje me arsyetimin e vendimit. Gjykata duhet të marrë një kohë të arsyeshme për arsyetimin dhe dorëzimin e vendimit në sekretari, kjo e fundit njofton kopjen e vendimit palëve të interesuara. Vendimi përfundimtar i gjykatës duhet t'u njoftohet palëve në zbatim të parimit të procesit të rregullt ligjor. Në lidhje me njoftimin e vendimit duhen mbajtur parasysh nenet 171/a (3)^[13] dhe 316^[14] të Kodit të Procedurës Civile.

Në Kodin e Procedurës Penale parashikohet se pas marrjes së vendimit bëhet arsyetimi i tij duke u bazuar në provat dhe ligjin penal, si dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues dhe se kur vendimi shpallet i përmbledhur, ai arsyetohet i plotë brenda 30 ditëve nga shpallja e tij. Ndërsa kur personi i dënuar është në masë sigurimi personal, sipas neneve 237 dhe 238 të këtij Kodi, vendimi arsyetohet brenda 15 ditëve nga data në të cilën është shpallur ose brenda 30 ditëve kur është gjykuar nga Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Në lidhje me njoftimin e vendimit duhet mbajtur parasysh neni 386, paragrafi 2 i KPP që përcakton se vendimi u njoftohet palëve në adresën e deklaruar prej tyre. Njoftimi i kryer në adresën e deklaruar nga palët konsiderohet i realizuar. Arsyetimi i vendimeve dhe depozitimi i tyre në sekretarinë e gjykatës për të vijuar më tej me njoftimin e vendimit palëve, është parashikuar në nene të ndryshme, pasi legjislatori ka mbajtur parasysh natyrën e ndryshme të çështjeve penale, por gjithashtu edhe natyrën e ngutshme të tyre, duke përcaktuar në mënyrë specifike për çështje të ndryshme afatet për arsyetimin e vendimit dhe sigurisht duke i qëndruar besnik parashikimit të nenit 382 të KPP, nëse afatet nuk janë përcaktuar specifikisht.

Parimi i gjykimit brenda një afati të arsyeshëm nuk duhet të keqkuptohet, pasi shpejtësia e kryerjes së veprimeve procedurale nuk e përjashton, përkundrazi, e nënkupton kryerjen me cilësi të këtyre veprimeve të gjykatës. Thënë kjo, efienca në drejtësi është një kriter i rëndësishëm për zhvillimin dhe konsolidimin e një procesi të rregullt ligjor, si dhe për rivendosjen e të drejtave të palëve të pretenduara të shkelura.

Vonesat e pajustificuara në dorëzimin e vendimeve të arsyetuara pengojnë ecurinë normale të procesit të dhënies së drejtësisë dhe për pasojë dëmtojnë të drejtën e subjekteve për një proces të rregullt gjyqësor; duke iu cenuar palëve të drejtën për të pasur arsyetimin e vendimit në mënyrë që të vlerësojnë kushtet e marrjes së tij dhe eventualisht për të disponuar me ushtrimin e së drejtës së ankimit; duke dëmtuar dukshëm imazhin e drejtësisë dhe besimin e publikut në të, për sa kohë tejkalimi i afateve logjike dhe normale, është thujse i barabartë me mungesën e drejtësisë. Mungesa e arsyeve mbi të cilat

¹³ "...Vendimet e shpallura jashtë seancës dhe ato ndaj të cilave lejohet ankim i veçantë u komunikohen palëve të interesuara nga sekretari i seancës, jo më vonë se tre ditë nga shpallja e tyre..."

¹⁴ "...Vendimet përfundimtare, jopërfundimtare dhe të ndërmjetme të gjykatës, për të cilat është parashikuar e drejta e ankimit, u njoftohen palëve ose pjesëmarrësve të tjerë në proces, brenda tre ditëve nga marrja e vendimit ose, në rast se vendimi i arsyetuar shpallet më vonë, brenda tre ditëve pas shpalljes së vendimit të arsyetuar..."

bazohet vendimi për një afat të gjatë cenon thelbin e të drejtës së ankimit, të garantuar nga neni 43 i Kushtetutës^[15].

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 5, datë 12.12.2013^[16], kanë elaboruar rrethanat në të cilat vonesat në arsyetimin e vendimit gjyqësor passjellin përgjegjësi disiplinore për gjyqtarin. Në këtë vendim gjykata ka referuar edhe në jurisprudencën e GJEDNJ [.... konstatohet se kjo gjykatë në shumë çështje e ka konsideruar vonesën në arsyetimin e vendimeve gjyqësore si cenim të procesit të rregullt ligjor (neni 6 i Konventës). Në referim të vendimeve të kësaj gjykate, por edhe praktikës së saj në përgjithësi "case law", gjykatat kanë detyrimin që të respektojnë parimin e rëndësishëm "të përfundimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm". Sa më sipër, si pjesë përbërëse e procesit të rregullt ligjor, garanton mbrojtjen e të gjitha palëve të përfshira në procesin gjyqësor ndaj "vonesave të tepruara procedurale", që në administrimin e drejtësisë rrezikojnë të drejtat e palëve dhe shtetin e së drejtës. Një vendim i vonuar madje mund të zhbëjë edhe vetë arsyen për të cilën është dhënë vendimi, pasi dhënia e tij në vonesë, mund të bëjë që ai të jetë krejt i pavlefshëm për palën e interesuar. Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut kërkon garantimin e procesit gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm (neni 6)].

Nga shqyrtimi i të dhënave objekt inspektimi rezulton se numri i gjyqtarëve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër nuk ka qenë i plotë sipas organikës, si pasojë e vendimmarrjeve të procesit të rivlerësimit kalimtar, daljes në pension, dorëheqjeve të gjyqtarëve dhe transferimin e përkohshëm me pëlqim. Ky proces natyrshëm ka krijuar kosto për qytetarët në tejzgjatjen e afateve për gjykimin e çështjeve gjyqësore duke krijuar një problematikë që ka të bëjë me sistemin në tërësi, duke bërë që gjyqtarët që ushtrojnë efektivisht detyrën të përballen me një volum të shtuar pune e duke ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në rendimentin dhe eficiencën e gjyqtarit. Kjo është një situatë që është jashtë kontrollit të magjistratit dhe që mund të lidhet me mosfunksionimin e sistemit gjyqësor për shkak të vakancave të krijuara e mosplotësimit të organikës.

Në vijim të analizës së mësipërme, ngarkesa në punë që shoqëron sot magjistratët, për shkak të mosplotësimit të organikës në të gjitha gjykatat e vendit është një kriter objektiv që mbahet parasysh me numrin total të çështjeve civile dhe kohën e nevojshme për të arsyetuar vendimet gjyqësore të dhëna, ndaj dhe bazuar në këtë kriter objektiv, koha që i është dashur magjistratëve për të arsyetuar vendimet gjyqësore i shërben jo vetëm rritjes së cilësisë në aspektin përmbajtësor të vendimit gjyqësor të dhënë në drejtim të palëve ndërgjyqëse që ky vendim i drejtohet, por edhe forcimit të besimit të publikut për një gjykim të drejtë, ku thelbi i këtij parimi është një vendim gjyqësor i mirë arsyetuar.

III. Gjetjet e inspektimit

¹⁵ Shih vendimin nr. 289, datë 18.04.2017 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë në çështjen L. Hoxha kundër KLD.

¹⁶ Çështja me palë: paditës Neritan Tabaku, kundër të paditurit KLD-së, me objekt padi: kundërshtim vendimi të KLD-së për shkarkimin e paditësit nga detyra e gjyqtarit.

Të dhënat e vendosura në dispozicion nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër janë vlerësuar në përputhje me afatet procedurale të parashikuara në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale dhe Kodit të Procedurës Civile, kërkesat e vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 150, datë 29.03.2023, “Për miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, kategoria e dytë dhe e tretë, me zyra shërbimi”; Rregullores së Brendshme nr. 109, datë 04.07.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Veprimtarisë Administrative dhe Gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër”, (akti në fuqi në periudhën objekt inspektimi).

Referuar qëllimit dhe objektivit të inspektimit, analizimit të të dhënave të grumbulluara nga ky inspektim nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër trajtimi në mënyrë shteruese i problematikave të dala gjatë realizimit të inspektimit rezulton se:

Grupi i inspektimit pasi shqyrtoi të dhënat shkresore të nisura nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, i kryqëzoi me të dhënat tabelore duke nxjerrë një informacion fillestar mbi mënyrën e dorëzimit të dosjeve në kryesekretari, veprimtarinë e sekretarisë në momentin e dorëzimit të dosjeve gjyqësore të përfunduara dhe gjithashtu një panoramë të përgjithshme mbi afatet e përgjithshme të dorëzimit të dosjeve në Kryesekretarinë e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër.

Në kuadër të inspektimit është vlerësuar i nevojshëm saktësimi i dokumentacionit pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër pasi gjatë këqyrjes dhe përpunimit të materialit janë vënë re mospërputhje midis materialit shkresor dhe tabelave të plotësuara, nga ana e kësaj gjykate, për këtë inspektim. Ndër të tjera është konstatuar se regjistrat e çështjeve “Pushim procedimi”, ishin plotësisht të palexueshme, nga fotokopjimi i kryer dhe i nisur pranë ILD-së duke e bërë të pamundur konkludimin për këtë pjesë të çështjeve të trajtuara dhe shpallura nga kjo gjykatë për periudhën objekt inspektimi. Librat e regjistrimit të vendimeve kanë pasur pasaktësi në mënyrën e numërimit, si numërtime të gabuara dhe/ose numra të kapërcyer. Disa çështje të cilat rezultojnë në regjistra nuk rezultojnë në tabelat e plotësuara nga gjykata dhe anasjelltas. Për çështje konkrete për shkak të mënyrës jo të qartë të regjistrimit të të dhënave në regjistrat përkatës bëhet i vështirë identifikimi i palëve pjesëmarrëse në proces dhe numrit të vendimit përkatës. Për të bërë të mundur saktësimin dhe plotësimin e informacionit të nevojshëm për konkludimin e inspektimit, ka dalë e nevojshme kryerja e një vizite pranë kësaj gjykate, për kryerje të veprimeve në funksion të këtij inspektimi.

Gjatë vizitës së kryer në datën 11.07.2025 në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër u kryen veprimet si më poshtë^[17]:

¹⁷ Shih procesverbalin nr. 265/1 prot., datë 11.07.2025 regjistruar në ILD me nr. 1019/8 prot., datë 11.07.2025.

1. U verifikuan fizikisht regjistrat “numërorët e vendimeve” civile dhe penale, dhe u saktësua mënyra sesi plotësohen regjistrat pranë kësaj gjykate.
2. U verifikuan fizikisht regjistrat e çështjeve të ardhura, “Kërkesa penale”, “Pushime procedimi” dhe “Masa sigurimi”.
3. U verifikuan të dhënat e regjistrave të “Pushimeve të procedimit” të cilat ishin të palexueshme nga dokumentacioni i nisur me shkresë nga gjykata. Gjatë vizitës u konstatua që ishte problem fotokopjimi dhe regjistrat origjinalë ishin të lexueshëm, identifikoheshin çështjet gjyqësore, por kishte raste kur në to nuk ishin plotësuar të gjitha rubrikat e parashikuara në regjistër duke bërë të nevojshme plotësimin e të gjitha rubrikave në vijim.
4. U verifikuan të dhënat e librave të dorëzimit të dosjeve gjyqësore në kryesekretari, dhe mënyra e shënimit të informacionit në to.
5. U verifikuan dhe saktësuan të dhënat e dubluara në tabelat e përgatitura nga gjykata.
6. U verifikuan të dhënat e tabelave të nisura nga gjykata, pas rregullimit të gabimeve e paqartësive dhe plotësimit të mungesave të tabelave (të konstatuara nga vizita në ambientet e gjykatës) si dhe u administrua një kopje e tabelës në mënyrë shkresore dhe elektronike.
7. U verifikuan dhe saktësuan të dhënat mbi gjetjet në regjistrat e numërimit të vendimeve penale, të cilat rezultojnë me fraksion si dhe mbi numrat e konstatuar të kapërcyer në numërorët penalë.
8. U verifikuan të dhënat e evidentuara mbi pasaktësitë në plotësimin e librave të dorëzimit të çështjeve gjyqësore nga gjyqtarët, ku evidentojmë: hedhjen e të dhënave të çështjeve të ndryshme në të njëjtën rubrikë ku evidentohet data e dorëzimit vetëm për një çështje gjyqësore; hedhja e të dhënave jashtë rubrikave të dorëzimit të një çështje gjyqësore.
9. U morën të dhëna mbi ngarkesën e gjyqtarëve për periudhën e verifikimit.

Nga formati i raportimit 3-mujor, për periudhën prill-qershor 2024 rezultojnë se ngarkesa e çështjeve gjyqësore për gjykatën dhe për çdo gjyqtar ka qenë si më poshtë:

Nr	Gjyqtari	Nr. i çështjeve të mbartura nga 2023	Nr. i çështjeve të regjistruara të reja (01 Janar-30 Qershor 2024)	Nr. i çështjeve të gjykuara	Nr. i çështjeve në shqyrtim
1.	Marjola Beluli	304	358 (59)	406	315
2.	Nertila Përallaj	367	370 (76)	373	440

3.	Entela Selmanaj	311	378 (76)	339	426
4.	Suela Dashi	220	152	157	4 (211)

Sipas sqarimit të vendosur në formatin e raportit 3-mujor rezulton se me urdhër të zv/kryetarit të gjykatës nr. 44, datë 09.05.2024 si dhe urdhër nr. 53, datë 17.05.2024, lidhur me rishortimin e çështjeve gjyqësore në ngarkim të gjyqtare Suela Dashi (211 dosje gjyqësore). Janë rishortuar me urdhër të titullarit, 211 dosje.

Gjatë kësaj periudhe ka pasur dhe 6 gjyqtarë të deleguar për gjykimin e 7 çështjeve të mbartura nga viti 2023. Janë rishortuar me urdhër të titullarit 211 dosje të gjyqtare Suela Dashi; 59 dosje gjyqtare M. Beluli, 76 dosje gjyqtare N. Përallaj dhe 76 dosje gjyqtare E. Selmanaj. Vlerat e vendosura në kllapa janë sqaruese dhe nuk janë përfshirë në llogaritje.

- Totali i vendimeve **civile të themelit** të shpallura për periudhën kohore 01.04.2024 deri më 30.06.2024 është **181** vendime, nga të cilat sipas klasifikimit të periudhës kohore nga shpallja në dorëzimin e vendimeve rezultoi:

Të dorëzuara në afat, pra brenda afatit 20 ditor: 94 vendime ose 51.7 %.

Të dorëzuara brenda afatit 21-30 ditor: 35 vendime ose 19.2 %.


Të dorëzuara brenda afatit 31-60 ditor: 22 vendime ose 11.5 %.

Të dorëzuara brenda afati 61-90 ditor: 22 vendime ose 11.5 %.

Të dorëzuara brenda afatit 91-120 ditor: 8 vendime ose 6.1 %.

Panoramën e gjendjes së dorëzimit të vendimeve civile të themelit të arsyetuara nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë sipas dokumentacionit të

vendosur në dispozicion dhe verifikimit nga grupi i inspektimit paraqitet si në grafikun vijues:




- Totali i vendimeve për **kërkesat civile** të shpallura për periudhën kohore 01.04.2024 deri më 30.06.2024 është **53** vendime, nga të cilat sipas klasifikimit të periudhës kohore nga shpallja në dorëzimin e vendimeve rezultoi:

Të dorëzuara në afat, pra brenda afatit 20 ditor: 45 vendime ose 85 %.

Të dorëzuara brenda afatit 21-30 ditor : 8 vendime ose 15 %.

Të padorëzuara deri në datën 20.05.2024: 0 vendime ose 0 %.

Panoramën e gjendjes së dorëzimit të vendimeve për kërkesat civile të arsyetuara nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë sipas dokumentacionit të vendosur në dispozicion dhe verifikimit nga grupi i inspektimit paraqitet si në grafikun e mëposhtëm:



[Handwritten signatures]

Duke marrë në konsideratë ngarkesën mesatare vjetore të një gjyqtari sipas të dhënave të evidentuara si më sipër, e cila ndikon në kohëzgjatjen e çështjeve të përfunduara, në arsyetimin dhe dorëzimin e vendimeve të shpallura në sekretari, rezulton se brenda afatit 30-ditor janë dorëzuar 78 % e vendimeve, duke u konsideruar kështu në shumicën e rasteve, si koha e arsyeshme që i nevojitet gjyqtarit/gjykatës të dorëzojë vendimin përfundimtar të arsyetuar^[18].

Nga trajtimi i të dhënave, mbi çështjet me karakter penal, të administruara gjatë inspektimit rezultoi si vijon:

Në zbatim të nenit 382, pika 3 të KPP, në të gjitha çështjet penale të themelit ku personi i dënuar është në masë sigurimi personal, sipas neneve 237 dhe 238 të këtij Kodi, vendimi arsyetohet brenda 15-ditëve nga data në të cilën është shpallur. Nga të dhënat e dërguara nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjyrokastër konstatohet që në **23** çështje **penale themeli me të arrestuar** të përfunduara gjatë periudhës së këtij inspektimi:

Të dorëzuara në afat, pra brenda afatit 15-ditor: 12 vendime ose 52.1 %.

Të dorëzuara brenda afatit 16-20 ditor: 2 vendime ose 8.7 %.

Të dorëzuara brenda afatit 21-30 ditor: 4 vendime ose 17.4 %.


Të dorëzuara brenda afati 31-60 ditor: 2 vendime ose 8.7 %.

Të dorëzuara brenda afatit mbi 61-120 ditor: 3 vendime ose 13.1 %.

Panoramën e gjendjes së dorëzimit të vendimeve penale të themelit ku personi i dënuar është në masë sigurimi personal, të arsyetuara nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjyrokastër sipas dokumentacionit të vendosur në dispozicion dhe verifikimit nga grupi i inspektimit paraqitet si më poshtë:

¹⁸ Në një analizë më të hollësishme lidhur me numrin e dosjeve të shpallura por të padorëzuara brenda afatit ligjor, u gjet mesatarja e kohës që i është dashur gjyqtarëve për të plotësuar këtë detyrë. Për të arritur në gjetjen e afatit që i është dashur gjyqtarëve për dorëzimin e dosjeve, u procedua duke zbritur nga numri i përgjithshëm i dosjeve të shpallura, brenda periudhës së inspektimit, numrin e dosjeve të dorëzuara brenda afatit ligjor dhe numrin e dosjeve të padorëzuara ende deri në datën 10.05.2024 dhe del shuma e përgjithshme e dosjeve të dorëzuara tej afateve të parashikuara në ligj, pra dosjet e dorëzuara me vonesë. Në bazë të kësaj shume u përllogarit përqindja e dosjeve të dorëzuara brenda afatit 60 ditor dhe u mor si afat maksimal i dorëzimit të vendimeve të arsyetuara dhe dosjeve gjyqësore në sekretari.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë, Penale Themeli me Arrest



- Në zbatim të nenit 382, pika 2, për çështjet **penale të themelit, ku i pandehuri nuk ndodhet me masë sigurimi personal**, kur vendimi shpallet i përmblodhur, ai arsyetohet i plotë brenda 30 ditëve nga shpallja e tij. Nga të dhënat rezultoi se nga totali prej **55** çështjesh:

Të dorëzuara në afat, pra brenda afatit 30 ditor: 46 vendime ose 83.7 %.

Të dorëzuara brenda afatit 31-40 ditor: 2 vendime ose 3.6 %.


Të dorëzuara brenda afatit 41-60 ditor: 1 vendim ose 1.8 %.

Të dorëzuara brenda afati 61-120 ditor: 5 vendime ose 9.1 %.

Të padorëzuara: 1 vendim ose 1.8 %

Panoramën e gjendjes së dorëzimit të vendimeve penale të themelit pa masë sigurimi personal, të arsyetuara nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë sipas dokumentacionit të vendosur në dispozicion dhe verifikimit nga grupi i inspektimit paraqitet si më poshtë:

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë, Penale Themeli pa arrest



[Signature]


- Në lidhje me çështje të kategorisë “Seancë paraprake” për çështjet me objekt “Dërgimin e çështjes në gjyq” në zbatim të nenit 332, germet “dh”, “a” dhe “c”, rezultoi se në total janë **68** çështje, nga të cilat **53** janë trajtuar sipas germës “c”, kur i pandehuri ka kërkuar gjykim të shkurtuar dhe për to është zbatuar afati i dorëzimit të çështjeve penale të themelit sipas nenit 382 të K. Pr. Penale dhe të **53** çështjet janë trajtuar sipas afatit 30 ditor të përcaktuar në ligj, për çështjet penale të themelit. Ndërkohë që **15** prej tyre kanë dalë me vendim për “Dërgimin në Gjyq” në zbatim të nenit 332, germet “dh”, dhe “a” dhe afati i dorëzimit të tyre është 10 ditë, të cilat reflektohen si vijon:

Të dorëzuara në afat, pra brenda afatit 10 ditor: 11 vendime ose 73.3 %.

Të dorëzuara brenda afatit 11-20 ditor: 3 vendime ose 20 %.

Të dorëzuara brenda afatit 21-50 ditor: 1 vendim ose 6.7 %.

Panoramën e gjendjes së dorëzimit të vendimeve të seancave paraprake të arsyetuara nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër sipas dokumentacionit të vendosur në dispozicion dhe verifikimit nga grupi i inspektimit paraqitet si më poshtë:



Përsa i përket çështjeve penale të veçanta, që kanë objekt “**Vleftësim arresti/ndalimi dhe caktim mase sigurimi**” ose “**Zëvendësim/revokim mase sigurimi**”, është llogaritur afati procedural 5 ditë i parashikuar për efekt të së drejtës së ankimit, referuar nenit 249 të K. Pr. Penale. Rezultoi se në total për periudhën e inspektuar janë **65** çështje që lidhen me masat e sigurimit nga të cilat:


Të dorëzuara në afat, pra brenda afatit 5 ditor: 31 vendime ose 47.7 %.

Të dorëzuara brenda afatit 6-10 ditor: 12 vendime ose 18.5 %.

Të dorëzuara brenda afatit 11-30 ditor: 8 vendime ose 12.3 %.

Të dorëzuara brenda afati 31-60 ditor:	5 vendime ose 7.7 %.
Të dorëzuara brenda afatit mbi 61-90 ditor:	5 vendime ose 7.7 %.
Mbi 90 ditë	3 vendime ose 4.6
Të padorëzuara deri në datën 30.05.2025:	1 vendim ose 1.5 %.

Panoramën e gjendjes së dorëzimit të vendimeve të seancave të masave të sigurimit personal të arsyetuara nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër sipas dokumentacionit të vendosur në dispozicion dhe verifikimit nga grupi i inspektimit paraqitet si në grafikun vijues:




Për **kërkesat penale**, për të cilat nuk përcaktohet afat specifik për dorëzimin e vendimit të arsyetuar, u përdor afati i përgjithshëm i dorëzimit prej 30 ditësh i parashikuar në nenin 382 të K. Pr. Penale. Kështu në totalin e **41** vendimeve të dhëna për kërkesa penale gjatë periudhës së inspektimit:

Të dorëzuara në afat, pra brenda afatit 30 ditor:	32 vendime ose 78 %.
Të dorëzuara brenda afatit 31-40 ditor:	2 vendime ose 4.9 %.
Të dorëzuara brenda afatit 41-60 ditor:	0 vendime
Të dorëzuara brenda afatit 61-90 ditor:	2 vendime ose 4.9 %.
Të dorëzuara brenda afatit mbi 91-120 ditor:	1 vendim ose 0.3 %.
Mbi 90 ditë	9 vendime ose 3.4 %

Panoramën e gjendjes së dorëzimit të vendimeve të kërkesave penale të arsyetuara nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër sipas

dokumentacionit të vendosur në dispozicion dhe verifikimit nga grupi i inspektimit paraqitet si në grafikun vijues:



Në lidhje me kërkesat me objekt **“Lejim përgjimi/zgjatje afat përgjimi”** sipas informacionit të dërguar nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër rezulton që në **42** përgjimet e kësaj periudhe të 42 ose 100 % e tyre janë dorëzuar brenda afatit 24 orësh të përcaktuar nga neni 222/4 i K. Pr. Penale.

Përsa i përket kërkesave me objekt **“Shuarje mase sigurimi”**, në zbatim të nenit 261/3 dhe nenit 248/2 të K. Pr. Penale përcaktohet që vendimi i arsyetuar duhet të dorëzohet brenda afatit procedural 48 orëve nga shpallja e tij. Nga të dhënat konstatohet se totali i vendimeve të shpallura për “Shuarje mase sigurimi” për periudhën e inspektimit është **12**, prej të cilave:

Të dorëzuara në afat, pra brenda afatit 2 ditor: 2 vendime ose 16.7 %.


Të dorëzuara brenda afatit 3-10 ditor: 4 vendime ose 33.3 %.

Të dorëzuara brenda afatit 90-100 ditor: 5 vendime ose 41.7 %.

Të padorëzuara 1 vendim ose 8.3 %

Panoramën e gjendjes së dorëzimit të vendimeve të kërkesave për shuarje mase, të arsyetuara nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër sipas dokumentacionit të vendosur në dispozicion dhe verifikimit nga grupi i inspektimit paraqitet si më poshtë:

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, Shuarje Mase



Përsa i përket çështjeve penale për të cilat është vendosur **pushimi i procedimit penal**, të cilat trajtohen në zbardhje të vendimit sipas nenit 382 të Kodit të Procedurës Penale, afati i dorëzimit të vendimit të arsyetuar është 30 ditë. Në total pushime gjykimi për periudhën e inspektuar janë **264** çështje, nga të cilat:

Të dorëzuara në afat, pra brenda afatit 30 ditor: 218 vendime ose 82.5 %.

Të dorëzuara brenda afatit 31-40 ditor: 29 vendime ose 10.9 %.


Të dorëzuara brenda afatit 41-60 ditor: 7 vendime ose 2.6 %.

Të dorëzuara brenda afati 61-90 ditor: 1 vendim ose 1.7 %.

Mbi 90 ditë 9 vendime ose 3.4 %.

Panoramën e gjendjes së dorëzimit të vendimeve të kërkesave pushim procedimi penal, të arsyetuara nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër sipas dokumentacionit të vendosur në dispozicion dhe verifikimit nga grupi i inspektimit paraqitet si më poshtë:

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, Pushim procedimi



[Handwritten signatures]

Nga kontrolli i të dhënave të vendosura në dispozicion nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, gjatë inspektimit, evidentohen problematikat e mëposhtme:

- i. Rezultuan mospërputhje midis materialit shkresor dhe tabelave të plotësuara, për këtë inspektim. Disa çështje të cilat rezultojnë në regjistra nuk rezultojnë në tabelat e plotësuara nga gjykata dhe anasjelltas.
- ii. Regjistrat e çështjeve "Pushim procedimi", ishin plotësisht të palexueshëm, nga fotokopjimi i tyre, duke e bërë të pamundur konkludimin për këtë pjesë të çështjeve të trajtuara dhe të shpallura nga kjo gjykatë për periudhën objekt inspektimi. Nga vizita e kryer pranë kësaj gjykate u verifikua që ishte problem i paqartësisë së fotokopjimit të dokumentit dhe çështjet gjyqësore identifikoheshin qartësisht nga regjistri institucional.
- iii. Në librat e regjistrimit të vendimeve u konstatuan pasaktësi në mënyrën e numërimit, si numërtime të gabuara dhe/ose numra të kapërcyer. Për çështje konkrete për shkak të mënyrës jo të qartë të regjistrimit të të dhënave në regjistrat përkatës bëhet i vështirë identifikimi i palëve pjesëmarrëse në proces dhe numri i vendimit përkatës.
- iv. Në plotësimin e librave të dorëzimit të çështjeve gjyqësore nga gjyqtarët, u konstatuan pasaktësi lidhur me: hedhjen e të dhënave të çështjeve të ndryshme në të njëjtën rubrikë ku duhet të evidentohet data e dorëzimit vetëm për një çështje gjyqësore; hedhjen e të dhënave jashtë rubrikave të dorëzimit të një çështjeje gjyqësore.
- v. Rezultoi se gjykata e inspektuar tregoi gatishmërinë dhe bashkëpunimin për këtë inspektim tematik.

Nga të dhënat e administruara gjatë inspektimit rezultoi se:

1. Nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër duhet të ishin respektuar kërkesat e Rregullores së Brendshme nr. 109, datë 04.07.2014 (në fuqi në periudhën objekt inspektimi), pavarësisht se kjo rregullore duhej të ishte rishikuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 98/2016 dhe përshkrimeve standarde të punës, të miratuara nga KLGJ me vendimin nr. 150, datë 29.03.2023. Në këtë rregullore evidentohet qartësisht se ndjekja e ecures së dorëzimit të dosjeve gjyqësore të përfunduara në sekretarinë gjyqësore sipas afateve procedurale të parashikuara në ligj dhe libri i marrjes në dorëzim të praktikave të çështjeve nga sekretaret e seancës është kompetencë e Kancelares.
2. Përsa i përket librave të dorëzimit të dosjeve në kryesekretari, u konstatua që secili gjyqtar ka një libër personal të sekretuar dhe numërtuar, ky libër administrohet nga sekretarja gjyqësore e cila firmos në ditën e dorëzimit të dosjes në kryesekretari dhe kundërfirmohet nga kryesekretaria. Në plotësimin e librave të

dorëzimit të çështjeve gjyqësore nga gjyqtarët, u konstatuan pasaktësi lidhur me: hedhjen e të dhënave të çështjeve të ndryshme në të njëjtën rubrikë ku duhet të evidentohet data e dorëzimit vetëm për një çështje gjyqësore; hedhjen e të dhënave jashtë rubrikave të dorëzimit të një çështjeje gjyqësore.

Respektimi i kërkesave të rregullores të miratuar rishtazi nr. 112/3 prot., datë 19.11.2024, sjell nevojën e mbajtjes dhe administrimit të librit të dorëzimit të dosjeve gjyqësore nga kryesekretaria e gjykatës, në përgjegjësinë e të cilës është mbajtja e regjistrave manuale dhe elektronike të gjykatës sipas përshkrimeve të punës të miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Kjo do të mundësojë evitimin e këtyre gabimeve dhe shënimeve të konstatuara sa më sipër, të cilat sjellin paqartësi në evidentimin e dorëzimit të dosjeve gjyqësore sipas afateve procedurale.

3. Regjistrat “numërorët e vendimeve” civile dhe penale, plotësohen nga kryesekretaria sipas rubrikave që përmbajnë, konstatohen gabime materiale si kapërcim numrash dhe vendime të numërtuara me fraksion të numrave të tjerë.
4. U konstatua se regjistrat e çështjeve penale me objekt “Pushim procedimi” nuk janë plotësuar me informacionin e plotë sipas rubrikave të regjistratit, duke e bërë të vështirë identifikimin e çështjeve.
5. Përsa i përket regjistrave të numërtimit të vendimeve penale konstatohet se vendimet penale që janë regjistruar me fraksion, janë numërtuar me vonesë dhe jo në datën e shpalljes së vendimit gjyqësor duke sjellë parregullsi në evidentimin e datës së saktë në numërtimin e vendimit gjyqësor. Disa nga problematikat e konstatuara janë si vijon:
 - a) Në regjistrin e numërtimeve të çështjeve civile të themelit numri 128, datë 02.05.2024, hedhur gabim, me një shënim në regjistër, pa procesverbal bashkëlidhur, ndërkohë ka vazhduar numërtimi normal, me të njëjtin numër rendor në vazhdim.
 - b) Numri rendor 143, datë 09.05.2024 dhe datë 04.04.2024, është i përsëritur 2 herë. Nga regjistri civil rezulton se çështja me nr. 834 Akti, është numërtuar jashtë radhe dhe me datë të mëparshme, pra është numërtuar me vonesë dhe ka marrë të njëjtin numër rendor vendimi me çështjen nr. 101/21326-00090 akti, datë 05.04.2023, të po kësaj gjyqtareje. Për këtë problematikë nuk ka asnjë shënim specifik si dhe asnjë procesverbal shoqërues.
 - c) Në numrin rendor 166, janë regjistruar dhe kanë marrë të njëjtin numër vendimi, dy çështje të ndryshme, konkretisht çështja civile me nr. 642 Akti date 08.09.2020 dhe me nr. 702 Akti datë 09.09.2022. Të dyja këto çështje janë shpallur në të njëjtën ditë nga dy gjyqtare të ndryshme. Për këtë fakt nuk rezulton të jetë mbajtur procesverbal, si dhe t’i jetë bashkëlidhur regjistratit të numërtimeve të vendimeve civile të themelit.

- d) Numri rendor 188, që i përket çështjes civile me nr. 814 Akti, datë 10.10.2023, është numërtuar një ditë më vonë, në numrat rendorë që i përkasin datës 04.06.2024, nuk gjendet për këtë çështje procesverbal sqarues i bashkëlidhur në regjistrin e numërtimeve të vendimeve civile të themelit.
- e) Edhe numri rendor 211 i regjistrit të vendimeve civile të themelit, është përdorur dy herë për regjistrimin e dy çështjeve të ndryshme dhe konkretisht të njëjtin numër vendimi e mbajnë çështjet nr. 781 Akti, datë 12.12.2022 dhe nr. 875 Akti, data mungon në regjistër, të dy gjyqtareve të ndryshme. Për këtë fakt nuk ka procesverbal të bashkëlidhur në regjistër apo në gjykatë. Në regjistrin e numërtimeve të çështjeve civile të themelit, në numërtimin e numrit 105, datë 15.04.2025, është numërtuar gabim, një kërkesë për urdhër mbrojtje, edhe pse ka shënimin në fund të rreshtit (hedhur gabim), nuk rezulton të jetë mbajtur procesverbal, i cili të bëhet pjesë e numërorit civil.
6. Në lidhje me njoftimin e vendimeve gjyqësore konstatohet se këto komunikime janë realizuar nga kryesekretaria dhe sekretari i seancës, ndërkohë që K. Pr. Civile në nenin 171/a, paragrafi 3, detyron sekretarin e seancës që të komunikojë vetëm ato vendime gjyqësore ndaj të cilave lejohet ankim i veçantë jo më vonë se tre ditë nga shpallja e tyre.
7. Në librin e dorëzimeve të dosjeve gjyqësore të një magjistrateje, u konstatuan pasaktësi lidhur me evidentimin e datës së dorëzimit të çështjeve të ndryshme gjyqësore në të njëjtën rubrikë, ndërkohë që për çdo çështje gjyqësore duhet të evidentohet një datë më vetë dorëzimi e vendimit gjyqësor. Kjo lloj problematike evidentohet në mënyrë të shpeshtë në librin në dorëzimit të kësaj magjistrateje nëse libri i dorëzimit të ishte mbajtur sipas kërkesave të sipërcituara kjo problematikë do të evitohet.

IV. Konkluzionet

Inspektimi u zhvillua dhe përfshiu veprimtarinë e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjyrokastër si dhe të dhënat e administruara nga kjo gjykatë, për periudhën e inspektimit, mundësuan njohjen dhe krijimin e një panorame të përgjithshme mbi respektimin e afateve ligjore për arsyetimin e vendimeve gjyqësore të shpallura si dhe depozitimin e tyre së bashku me dosjet në sekretari nga magjistratët.

Nga të dhënat e administruara gjatë inspektimit për periudhën 01.04.2024 deri më 30.06.2024 rezultoi se në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjyrokastër janë shpallur:

- **181 vendime civile të themelit** të cilat janë dorëzuar të gjitha në kryesekretarinë e kësaj gjykate. Nga këto 94 vendime ose 51.7 % e totalit të vendimeve të shpallura janë arsyetuar dhe depozituar në sekretari brenda afatit ligjor 20 ditor, 35 vendime ose 19.2 % e totalit të vendimeve të shpallura janë dorëzuar të arsyetuara në sekretari brenda afatit 21-30 ditor, 21 vendime ose 11.5 % e totalit të vendimeve

të shpallura janë dorëzuar të arsyetuara në sekretari brenda afatit 31-60 ditor, 23 vendime ose 12,6 % e totalit të vendimeve të shpallura janë dorëzuar të arsyetuara në sekretari brenda afatit 61-90 ditor, 9 vendime ose 5 % e totalit të vendimeve të shpallura janë dorëzuar të arsyetuara në sekretari brenda afatit 91-120 ditor, 0 vendime ose 0 % e totalit të vendimeve të shpallura janë dorëzuar të arsyetuara në sekretari mbi afatin 121 ditor, i padorëzuara deri në datën 30.05.2024 nuk rezultojnë asnjë vendim.

- **78 vendime penale themeli**, të cilat për shkak të parashikimeve ligjore të Kodit të Procedurës Penale, janë kategorizuar sipas natyrës së çështjes dhe afatit ligjor përkatës për arsyetimin e vendimit, në rastet kur personi i dënuar është në masë sigurimi personal, sipas neneve 237 dhe 238 të këtij KPP, në total për periudhën e inspektuar janë **23 çështje** dhe në penale themeli të dënuar pa masë sigurimi personal, të cilat në total janë **55 çështje**. Nga të dhënat e dërguara nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë konstatohet që në 23 çështje penale të themelit ku personi i dënuar është në masë sigurimi personal, sipas neneve 237 dhe 238 KPP, rezultojnë të dorëzuara në afat, pra brenda afatit 15 ditor 12 vendime ose 52.1 %, të dorëzuara brenda afatit 16-20 ditor 2 vendime ose 8.7 %, të dorëzuara brenda afatit 21-30 ditor 4 vendime ose 17.4 %, të dorëzuara brenda afatit 31-60 ditor 2 vendime ose 8.7 %, të dorëzuara brenda afatit mbi 61-120 ditor 3 vendime ose 13.1 %. Në zbatim të nenit 382, pika 2, për çështjet penale të themelit, ku personi i dënuar **nuk është në masë sigurimi personal** kur vendimi shpallet i përmbledhur, ai arsyetohet i plotë brenda 30 ditëve nga shpallja e tij. Nga të dhënat rezultoi se nga totali prej 55 çështjesh të dorëzuara në afat, pra brenda afatit 30 ditor 46 vendime ose 83.7 %, të dorëzuara brenda afatit 31-40 ditor 2 vendime ose 3.6 %, të dorëzuara brenda afatit 41-60 ditor 1 vendim ose 1.8 %, të dorëzuara brenda afati 61-120 ditor 5 vendime ose 9.1 %, i padorëzuar 1 vendim ose 1.8 %.
- **68 vendime të seancave paraprake**. Për shkak të parashikimeve ligjore të Kodit të Procedurës Penale neni 332/dh, janë kategorizuar sipas natyrës së vendimmarrjes dhe parashikimit ligjor përkatës. Në totalin e vendimeve të seancave paraprake për periudhën e inspektuar rezultuan që **53 çështje** janë vendimuar sipas germës “c”, për të cilat është vlerësuar dërgimi i çështjes në gjykatën kompetente kur i pandehuri ka kërkuar gjykimin e shkurtuar, pasi kryen verifikimin mbi gjendjen e akteve, sipas parashikimeve të nenit 332/c të këtij Kodi, të cilat u referohen afateve të parashikuara në nenin 382 të KPP për arsyetimin e vendimit dhe **15 çështje** të cilat janë trajtuar sipas germës “a”, të nenit 332/dh dhe për të cilat afati i parashikuar për arsyetimin e vendimit pas shpalljes së tij është 10 ditor. Të dorëzuara në afat, pra brenda afatit 10 ditor, 11 vendime ose 73.3 %, të dorëzuara brenda afatit 11-20 ditor 3 vendime ose 20 %, të dorëzuara brenda afatit 21-50 ditor 1 vendim ose 6.7 %.
- **160 vendime kërkesa penale**, në të cilat përfshihen të gjitha kërkesat që lidhen me masat e sigurimit personat të cilat janë **65** për periudhën e inspektuar, kërkesat për

lejim përgjimi dhe zgjatje afati për lejim përgjimi të cilat janë **42**, kërkesat për shuarjen e masave të sigurimit të cilat për periudhën e inspektuar janë **12** dhe të gjitha kërkesat e tjera penale të cilat ngrihen pranë gjykatës pas dhënies së vendimit të themelit të cilat janë **41** për periudhën e inspektuar.

- Përsa i përket çështjeve penale, që kanë objekt **“Vleftësim arresti/ndalimi dhe caktim mase sigurimi”** ose **“Zëvendësim/revokim mase sigurimi”**, është llogaritur afati procedural 5 ditë i parashikuar për efekt të së drejtës së ankimit, referuar nenit 249 të KPP. Rezultoi se në total për periudhën e inspektuar janë **65** çështje që lidhen me masat e sigurimit nga të cilat, të dorëzuara në afat, pra brenda afatit 5 ditor 31 vendime ose 47.7 %, të dorëzuara brenda afatit 6-10 ditor 12 vendime ose 18.5 %, të dorëzuara brenda afatit 11-30 ditor 8 vendime ose 12.3 %, të dorëzuara brenda afati 31-60 ditor 5 vendime ose 7.7 %, të dorëzuara brenda afatit 61-90 ditor 5 vendime ose 7.7 %, mbi 90 ditë 3 vendime ose 4.6 %, të padorëzuara deri në datën 30.05.2025, 1 vendim ose 1.5 %.
- Numri i gjyqtarëve sipas strukturës organizative gjatë vitit 2024 është 7, ndërsa numri efektiv i gjyqtarëve që kanë ushtruar detyrën është 4. Ngarkesa mesatare vjetore e një gjyqtari të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër është 1010 çështje për gjyqtar, një rritje krahasuar me vitin 2023 (887.4 çështje)^[19] sipas raportit të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2024”
- Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër rezulton se: 71.2 % e vendimeve civile të themelit, rreth 100 % e kërkesave civile, janë dorëzuar brenda afatit 30 ditor. Rezulton gjithashtu që përsa i përket çështjeve penale në tërësi, pavarësisht afateve të tyre specifike, rreth 74.4 % janë dorëzuar brenda afateve ligjore dhe pjesa tjetër janë dorëzuar jashtë këtyre afateve, secila kategori sipas përcaktimeve përkatëse.
- Duke marrë në konsideratë ngarkesën mesatare vjetore të një gjyqtari në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër me 1010 çështje, e cila ndikon në kohëzgjatjen e çështjeve të përfunduara, në arsyetimin dhe dorëzimin e vendimeve të shpallura në sekretari rezulton se brenda afatit 30 ditor janë dorëzuar 78 % të vendimeve civile (themeli dhe kërkesa civile) të shpallura.
- Në rastin konkret, rezulton *prima facie* se, pavarësisht afateve të parashikuara në ligjin procedural civil (neni 308 i K. Pr. Civile), këto afate në shumicën e rasteve nuk janë zbatuar me rigorozitet nga ana e gjyqtarëve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre. Në këtë rast, mosrespektimi i afateve procedurale nga ana e magistratëve nuk duhet të konsiderohet *apriori* si një shkelje e mundshme

¹⁹ Faqe 113 e raportit “Mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2024”.

disiplinore. Për të arritur në konkluzionin nëse nga ana e magjistratëve janë ndërmarrë veprime/mosveprime të cilat mund të përbëjnë shkelje disiplinore apo veprimi/mosveprimi lidhet me veprimtarinë e tyre profesionale duhet të analizohen rast pas rasti nëpërmjet një procesi verifikimi apo hetimi disiplinor një sërë çështjesh të cilat kanë të bëjnë me identifikimin e elementëve faktikë dhe juridikë mbi përgjegjësinë disiplinore të magjistratëve sipas kërkesave të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

- Jo në çdo rast mosrespektimi i afateve të përcaktuara nga ana e legjislacionit procedural dhe në mënyrë të veçantë afatet e parashikuara për të dorëzuar brenda një afati të arsyeshëm vendimet e arsyetuara do të konsiderohet si shkelje e mundshme disiplinore. Që këto shkelje të konsiderohen si të tilla duhet të ketë një mungesë kujdesi dhe operativiteti, neglizhencë, apo aftësie profesionale të tilla që kalojnë “*kufirin e të arsyeshmes*” dhe që një sjellje e tillë nuk mund të justifikohet nga ana e magjistratit. Vonesa në arsyetimin dhe dorëzimin e vendimeve përbën shkelje disiplinore, gjithashtu kur përbën rast përsëritës të rëndë dhe të pajustificuar, si dhe në të njëjtën kohë, nuk ka ardhur si pasojë e ndonjë situatë që është jashtë kontrollit të magjistratit dhe që mund të lidhet me mosfunksionimin e sistemit gjyqësor.
- Duke pasur parasysh ndryshimet që sollë reforma në sistemin e drejtësisë dhe efektet e saj, veçanërisht lidhur me plotësimin e numrit të gjyqtarëve në gjykata dhe numrin e madh të çështjeve në pritje për t’u shqyrtuar në kuadër të vlerësimit të kohëzgjatjes së procedurave në lidhje me arsyetimin dhe dorëzimin e vendimeve gjyqësore duhet të tregohet një qasje sa më e kujdesshme. Ngarkesa në punë që shoqëron sot magjistratët, është një kriter objektiv që mbahet parasysh me numrin total të çështjeve civile dhe kohën e nevojshme për të arsyetuar vendimet gjyqësore të dhëna, ndaj dhe bazuar në këtë kriter objektiv, koha që i është dashur magjistratëve për të arsyetuar vendimet gjyqësore, i shërben jo vetëm rritjes së cilësisë në aspektin përmbajtësor të vendimit gjyqësor të dhënë në drejtim të palëve ndërgjyqëse që ky vendim i drejtohet, por edhe forcimit të besimit të publikut për një gjykim të drejtë, ku thelbi i këtij parimi është një vendim gjyqësor i mirëarsyetuar.
- Në këtë kuadër, për të arritur në konkluzionin nëse nga ana e magjistratëve janë ndërmarrë veprime/mosveprime të cilat mund të përbëjnë shkelje disiplinore apo veprimi/mosveprimi lidhet me veprimtarinë e tyre profesionale duhet të analizohen rast pas rasti nëpërmjet një procesi verifikimi apo hetimi disiplinor të gjitha rastet ku afati i arsyetimit dhe dorëzimit të vendimit gjyqësor tejkalon afatin, i cili konsiderohet si një “*kohë e arsyeshme*” që i nevojitet gjyqtarit/gjykatës të dorëzojë vendimin përfundimtar të arsyetuar.
- Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër rezulton se 78 % e vendimeve civile janë dorëzuar brenda afatit 30 ditor, duke u

konsideruar kështu në shumicën e rasteve, si koha e arsyeshme që i nevojitet gjyqtarit/gjykatës të dorëzojë vendimin përfundimtar të arsyetuar.

- Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër rezulton se: 71.2 % e vendimeve civile të themelit, rreth 100 % e kërkesave civile, janë dorëzuar brenda afatit 30 ditor. Rezulton gjithashtu që përsa i përket çështjeve penale në tërësi, pavarësisht afateve të tyre specifike, rreth 74.4 % janë dorëzuar brenda afateve ligjore dhe pjesa tjetër janë dorëzuar jashtë këtyre afateve, secila kategori sipas përcaktimeve përkatëse.
- Në këto kushte, paraprakisht vlerësohet se deri në momentin e kryerjes së inspektimit për dorëzimin e vendimeve civile të themelit, afati përcaktues dhe i domosdoshëm që duhet të merret në konsideratë, është afati 30 ditor si koha e arsyeshme që i nevojitet gjyqtarit/gjykatës të dorëzojë vendimin përfundimtar të arsyetuar, pasi vetëm ky afat mund të bëjë dallimin dhe të shërbejë si një kohë e arsyeshme në situatën konkrete të ngarkesës, organikës së paplotësuar dhe numrit të magjistratëve që kanë ushtruar funksionin në periudhën inspektuese, apo tipologjisë së çështjeve të gjykuara, mes nevojës për të arsyetuar dhe dorëzuar të gjitha vendimet gjyqësore, sipas afatit të parashikuar në nenin 308 të Kodit të Procedurës Civile dhe mundësisë dhe kapaciteteve aktuale të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër.

I. Rekomandimet

1. Për gjykatat subjekte të inspektimit:

- Raporti i inspektimit t'i njoftohet gjykatës së inspektuar në zbatim të parimit të transparencës së veprimtarisë inspektuese me qëllim njohjen me problematikat e konstatuara.
- Rekomandohet plotësim i regjistrave të çështjeve "Pushime procedimi" me këto elementë: numrin e aktit, datën e regjistrimit, emrin e gjyqtarit, emrin e kërkuarit, numrin e procedimit penal, emrin e personit ndaj të cilit ka nisur procedimi, përmbajtjen e kërkesës, vendimin e dhënë, datën kur është marrë vendimi dhe numrin e vendimit.
- Rekomandohet që librat e dorëzimit të dosjeve gjyqësore të mbahen dhe administrohen nga kryesekretaria e gjykatës, në përgjegjësinë e të cilës është mbajtja e regjistrave manuale dhe elektronike të gjykatës sipas përshkrimeve të punës të miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.
Në librat e dorëzimit të dosjeve gjyqësore civile, të dosjeve gjyqësore penale si dhe të kërkesave penale të pasqyrohen të dhëna e mëposhtme: numri dhe data e shpalljes së vendimit; numri i aktit dhe data e regjistrimit; palët ndërgjyqëse; gjyqtari që ka gjykuar çështjen dhe sekretarja e seancës; data e dorëzimit të dosjes nga gjyqtari te sekretari gjyqësor dhe data e dorëzimit të dosjes në kryesekretari;

firma e sekretarit gjyqësor dhe firma e kryesekretarit që merr në dorëzim dosjen gjyqësore.

- Rekomandohet që për të gjitha regjistrimet e vendimeve penale me fraksion, të ndryshojë procedura në librat e numërimit, duke vazhduar me numrin pasardhës, datën e shpalljes së vendimit dhe për gabime të tilla të mbahet procesverbal nga kryesekretaria, i cili t'i bashkëlidhet regjistrit të numërtimeve të vendimeve gjyqësore duke i raportuar kryetarit të gjykatës problematikat e hasura.
- Rekomandohet mbajtja e një regjistri për njoftimin e vendimit palëve, në të cilin të evidentohet data e njoftimit të vendimit, me qëllim realizimin e kërkesave ligjore të neneve 171 dhe 316 të Kodit të Procedurës Civile, i cili parashikon se vendimet përfundimtare, jopërfundimtare dhe të ndërmjetme të gjykatës, për të cilat është parashikuar e drejta e ankimit, u njoftohen palëve ose pjesëmarrësve të tjerë në proces, brenda tre ditëve nga marrja e vendimit ose, në rast se vendimi i arsyetuar shpallet më vonë, brenda tre ditëve pas shpalljes së vendimit të arsyetuar.
Njoftimi të bëhet nga personat përgjegjës të administratës gjyqësore në respektim të parashikimeve të K. Pr. Civile.

2. Për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë

Referuar gjetjeve të inspektimit vlerësohet se ka të dhëna lidhur me fakte që nëse provohen përbëjnë shkelje disiplinore të parashikuar sipas ligjit nr. 96/2016, "*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar. Në këto kushte rekomandohet:

- 1) Fillimi i verifikimeve në kuadër të ligjit nr. 96/2016 "*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, për të konstatuar nëse ka fakte të mjaftueshme për fillimin e hetimit disiplinor për magjistratë të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjyrokastër, për vendimet gjyqësore civile të shpallura e të dorëzuara të arsyetuara në sekretari pas 30 ditëve nga shpallja.
- 2) Fillimi i verifikimeve në kuadër të ligjit nr. 96/2016 "*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, për të konstatuar nëse ka fakte të mjaftueshme për fillimin e hetimit disiplinor për gjyqtarë të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjyrokastër për vendimet penale të shpallura e të depozituara në sekretari në kapërcim të afateve ligjore të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale.
- 3) Fillimi i verifikimeve në kuadër të ligjit nr. 96/2016 "*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, për pasaktësitë e vazhdueshme të evidentuara në librin e dorëzimeve të dosjeve gjyqësore të një magjistrateje.


Bazuar në nenin 147/d, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 194, pika 4 dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar,

PROPOZJMË:

1. Përfundimin e inspektimit tematik të nisur me vendimin nr. 16, datë 01.04.2025 “Mbi procedurën e shpalljes dhe arsyetimit të vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, për periudhën 01.04.2024-30.06.2024”, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
2. Caktimin e periudhës nga data 02.12.2025 deri në datën 30.05.2026 si periudhë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve.
3. Njoftimin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër për përfundimin e Inspektimit Tematik, duke i dërguar edhe një kopje të këtij raporti.
4. Njoftimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, me Raportin e Inspektimit, duke i dërguar një kopje të këtij raporti.

INSPEKTORËT

Erjena Bashari



Joana Sorraj

